

**KUR'ANI
DHE
IMAM HUSEJNI**

Tiranë, 2007

Titulli i librit: **Kur'ani dhe imam Husejni**

Autori: **Muhsin Karaeti**

Përktheu nga persishtja: **Redis Sheko**

Korrektoi: **Vullnet Merja**

Botoi: Shoqata “**Flladi**”



© Copyright: Shoqata “**Flladi**”

Tirazhi: **1000** kopje

Hyryje

Çdo njeri që lexon jetën e imam Husejnit (a.s.), të biri të Aliut (a.s.) do të shohë se roli i tij në jetën islame ka filluar shumë herët, sidomos rol të madh ka luajtur në kohën e hilafetit të babait të tij duke marrë pjesë në tri luftëra krah për krah me imam Aliun (a.s.): Lufta e Xhemelit, lufta e Sifinit, lufta e Nehrevanit.

Në kohën e hilafetit të vëllait të tij Hasani (a.s.) përjetoi të gjitha ndodhitë që ndodhën në atë kohë, ku ndër to ishte edhe «pajtimi». Pastaj imam Husejni (a.s.) së bashku me vëllanë e tij dhe Ehli Bejtin shkuan në Medine për të shpjeguar ligjet e sheriatit dhe për të mbrojtur shpalljen prej rrymës devijuese .

Pas vdekjes së vëllait të tij, imam Hasanit (a.s.), roli i imam Husejnit(a.s.) hyri në një fazë të re.

Për Hysejnin (a.s.) gjindet ajo pozitë e lartë në mesin e muslimanëve. Më poshtë po paraqesim disa hadithe të Profetit të cilat flasin për personalitetin e imam Husejnit (a.s.)

1 – Në Sahihin Termidhi thuhet: Ja’la El – Amirij ka transmetuar thënien e Profetit (sa): **"Husejni është prej meje dhe unë jam prej Husejnit. Allahu e don atë që e don Husejnin. Husejni është degë prej degëve të pemës së Ehli Bejtit..."**⁽¹⁾

2 – Një ditë imam Husejni (a.s.) kaloi pranë disa të varfërve, të cilët ishin të mbuluar me xhybe dhe po hanin copa buke. Ai i përshëndeti ata. Të varfërit e ftuan për të ngrënë. Ai (a.s.) u ul dhe tha: **"Nëse ky ushqim nuk do ishte sadekat do të haja me ju."**

Pastaj i tha atyre: **"Çohuni për në shtëpinë"**

(1) Fadail Hamsetu: V.3. F.261 – 263.

time." Ai (a.s) i ushqeu, i veshmbathi dhe urdhëroi që t'i jepnin atyre dërheme (para)."

3 – Shuajb ibën Abdurrahman ka transmetuar duke thenë: «**Ditën e vrasjes në shpinën e Husejnit u panë njolla. Për këtë pyetën Zejnel Abdinin (a.s.) (djalin e Husejnit).**

Ai tha: “Kjo është përshkak të trastave që mbante mbi shpinën e tij duke i shpërndarë nëpër shtëpitë e të vejave,

4 – Një shërbyes bëri një veprim i cili e meritonte edukmin. Imami(a.s) donte ta edukonte. Ai shërbyesi i tha: O Zotnia ime {... **dhe bllokuesit e inateve..**}.

imam Husejni (a.s.) tha: “Lëreni atë.”

Ai shërbyesi tha: “**Falësi për njerëzit**”.

Imam Husejni i tha (a.s): “**Unë të kam falur ty.**”

Shërbyesi tha: {Zoti i don bamirësit}.

Imam Husejni (a.s.) tha: “**Ti je i lirë për**

hir të Zotit. Ty do të jap më tepër se të jepja.”⁽²⁾

E të tjera hadithe të cilat nxjerrin në pah pozitën e imam Husejnit (a.s.)

Shoqata "Filladi", në kuadër të veprimtarive të saj, këtë radhë boton librin me titull "Kur'ani dhe imam Husejni". Edhe pse i vogël në volum, por në të gjinden shumë dobi për lexuesit.

Në përfundim, falenderojmë të gjithë ata që u morën me përgatitjen e librit. Gjithashtu, e lusim All-llahun e Plotfuqishëm që përkthyesin e këtij libri, i nderuari Redis Sheko, i cili me përkthimet e tij që ka kryer ta mbarërojë në këtë jetë. S'ka dyshim se t'i shërbesh së vërtetës, shpërblimi në botën tjetër do të jetë xheneti.

Shoqata "FLLADI"

(2) Ebu Alem në librin Ehli Bejti, Menakib Al Ebi Talib, Keshful Gumetu V.2.

The logo consists of several horizontal, wavy green lines that curve upwards on the right side, resembling a stylized book or a wave.

*Shoqata
Kur'aní dhe Slladi
imam Husejní (a.s.)*

Përderisa Kur'ani është fjala më e lartë (sejjidul kelam)¹, atëherë edhe imam Husejni është mbreti i dëshmorëve (sejjidu'sh shuheda).² Imam Zejnul Abidine (Sexhxad) në Sahifetu's Sexhadije (Përmbledhje të imam Sexhadit) rreth Kur'anit thotë: “وميزان القسط” (ballanca e të vërtetës, drejtësisë), imam Husejni urdhëron dhe thotë: “أمرتُ بالقسط”
“Urdhërova për drejtësi.”³

Përderisa Kur'ani është këshillë e Zotit; (موعظة من ربكم) (këshillë nga Zoti juaj)⁴, imam Husejni (a.s) në Ditën e Ashurasë urdhëroi e tha: “Mos u nxitoni derisa t'ju këshilloj drejt të vërtetës.”⁵ “لا تعجلو حتى اعظكم بالحق”

Përderisa Kur'ani udhëzon në vërtetësi⁽⁶⁾ “يهدى الى الرشيد”, imam Husejni (a.s) po ashtu urdhëron e thotë: “Unë ju ftoj juve për në rrugë të drejtë.”⁷ “ادعوكم الى سبيل الرشاد”

Përderisa Kur'ani është madhështor⁸; “العظيم”

”والقرآن“, imam Husejni (a.s) është posedues i përparësive të mëdha ⁹ << عظيم السوابق >>

Përderisa Kur’ani është vërtetësi dhe bindje ¹⁰ << وانه لحق اليقين >>, në zijaretin e imam Husejnit (a.s) thuhet: “Aq drejtë dhe çiltërsisht u fale, sa arrite në gradën e jekinit (bindjes së plotë).” ¹¹ << حتى اتاك اليقين >>

Përderisa Kur’ani ka pozitën e ndërmjetësimit ¹², po ashtu edhe imam Husejni (a.s) ka pozitën e ndërmjetësimit. ¹³ Në "وارزقتى شفاعة الحسين" - "نعم الشفيع القرآن" lutjen e dyzetë e dytë të Sahife Sexhadijes për Kur’anin thuhet se është flamur shpëtimi, << عَلَّمَ النَّجَاة >>, dhe në zijaretin e imam Husejnit po ashtu thuhet se ai është flamur udhëzimi. ¹⁴ << انه راية الهدى >>

Përderisa Kur’ani është shërues ¹⁵ << وننزل من القرآن ما هو شفاء >> varrit të imam Husejnit (a.s) është

shërues.¹⁶ <<طين قبر الحسين شفاء>>.

Përderisa Kur'ani është fener i urtësisë, imam Husejni (a.s) është portë e urtësisë së Allahut të Madhëruar. "السلام عليك يا باب حكمة رب العالمين"¹⁷

Përderisa Kur'ani udhëzon në të mira dhe ndalon nga të këqijat¹⁹ "فالقرآن أمر و زاجر", imam Husejni ka thënë: "*Qëllimi i të shkuarit tim në Kerbela është urdhërimi në të mira dhe ndalimi nga të këqijat.*"²⁰

<<اريد أن أمر بالمعروف و انهى عن المنكر>>

Përderisa Kur'ani është dritë,²¹ <<نوراً>> edhe imam Husejni (a.s) është dritë.

"كنت نوراً في الا صلاب الشامخة" (Ti ke qenë dritë në gjeneracionet më të larta)²²

Përderisa Kur'ani i përket gjithë kohërave dhe gjithë njerëzimit²³ <<لم يجعل القرآن لزمانٍ>>, po ashtu emri i imam Husejnit dhe gjurmët e Kerbelasë nuk do të fshihen në histori²⁴: <<لا يدرس و لا

يمحى اسمه>>

Përderisa Kur'ani është libri i bekuar ²⁵ >>

<<كتاب انزلناه اليك مبارك>> po ashtu edhe martirizimi i imam Husejnit për Islamin u bë shkak mbarësie dhe udhërrëfimi. ²⁶ >> اللهم

<<Përderisa në Kur'an nuk gjendet asnjë devijim; ²⁷ >> غير ذى

<<perreth imam Husejnit po ashtu do lexojmë: Nuk u gjend asnjë moment prirjeje prej Hakut (të vërtetës) drejt Batilit (të kotës). ²⁸ >> لم تمِل من حقّ الى الباطل <<

Përderisa Kur'ani është famëlartë ²⁹ >> انه

<<قرآن كريم>> po ashtu imam Husejni është posedues i moralit famëlartë <<و كريم الخلا ³⁰ >> نق

Përderisa Kur'ani është i dashur ³¹ >> انه

<<كتاب عزيز>> imam Husejni urdhëron dhe thotë: “Kurrë nuk shkoj nën barrën e poshtërsisë.” <<هيهات منّا الذلّة>> ³²

Përderisa Kur'ani është litar i fortë; ³³ >> ان

<<هذا القرآن... العروة الوثقى>> po ashtu imam Husejni është anije shpëtimi dhe litar i

fortë. ³⁴ << انَّ الحسين سفينة النجاة والعروة الوثقى >>
Përderisa Kur'ani është sqarim dhe dëshmi
e qartë ³⁵ << جائكم بينة من ربكم >>, imam
Husejni po ashtu është kësisoj. ³⁶ << أشهد أنكم
على بينة من ربكم >>

Përderisa Kur'anin duhet ta lexojmë me
qetësi dhe me ngadalësi ³⁷ << ورتل القرآن >>
<< ترتيلاً >>, po ashtu vizaretin (vizitën) për tek
mekami i imam Husejnit duhet që ta
kryejmë me hapa të ngadalta. << وامش بمشي >>
<< العبيد الذليل >>³⁸

Përderisa këndimi i Kur'anit duhet të jetë
melankolik << فاقروه بالحزن >>³⁹, po ashtu
edhe këndimi i vizaretit të (lutjeve të
posaçme që këndohen gjatë vizitës së)
imam Husejnit duhet të jetë melankolik. ⁴⁰
<< وزره و انت كئيب شعب >>

Vërtet, Husejni (a.s) është Kur'ani folës dhe
fizionomia e fjalës së Zotit.



*Motivi, singeriteti,
kënaqësia
dhe vetëdija në
Kerbela*

Në kundërshtim me botën e sotme që mbështetet tek pasuria, potenciali, informacioni, specializimi, teknologjia, Islami, rendimentet dhe imazhin e tërë këtyre i sheh përkrah besimit tek Zoti, nëpërmjet sinqeritetit, dëshirës dhe motivit.

Shembuj: Namazi pa dëshirë është bërë shembull kritikimi në Kur'an. ⁴¹ >> قاموا

<< كسالى (falen me përtaci). Bamirësia pa dëshirë është bërë objekt kritike në Kur'an "هم كارهون"⁴² Kryerja e punës pa dëshirë dhe e shoqëruar me

nxjerrje pretekstesh është e njëjtë me moskryerjen e saj. Beni Israilitët, vetëm pasi sollën mjaft pretekste, mezi sakrifikuan një lopë. Kur'ani urdhëron e thotë: "thuajse nuk e sakrifikuan", >> فذبحوها وماكادوا

<< يفعلون⁴³ **"...e therrën atë, për pak e lanë pa e kryer punën...."** Shumë herë Kur'ani i ka kritikuar ata persona që në kohën e shkuarjes në front, u mungonte dëshira. >>

<< اثاقلتم الى الارض “**U rënduat në vend** (si të ishite të gozhduar).” ⁴⁴ Për besimin dhe vëmendjen ndaj personave që në kohën e ankthit bëjnë dinakëri ndaj Zotit, Kur'ani kritikon dhe thotë: Posa që vijnë në prag të mbytjes, thërrasin Zotin, por sa u vjen shpëtimi, harrojnë فاذا ركبوا فى الفلك دعوا لله... >>⁴⁵ فلما نجاهم ...

“Kur hipin ata në anije (u këputet lidhja me tokën dhe frikësohen) i luten singerisht All-llahut, e kur i shpëton ata (dhe dalin) në tokë, po ata të njëjtit lusin idhujt.”

Besimi në çastin e rrezikut është punë e Faraonit, i cili në prag të mbytjes tha: “Besova!” dhe Zoti në përgjigje të tij urdhëroi e tha: << الآن و قد عصيت قبل >>⁴⁶ **“Atani beson, ndërsa më parë kundërshtove?!”** Në Kerbela ishte e pranishme dëshira. Imam Husejni urdhëron dhe thotë: "Vdekja është njëlloj si gjerdani në kraharorët e vajzave të reja."

Biri trembëdhjetë vjeçar, djali i Imam Hasanit (a.s.) hz. Kasim urdhëron dhe thotë: *“Vdekja tek mua është më e ëmbël se mjalti.”* Shokët e Imam Husejnit po ashtu thonin: *“Sikur të ngjallehim, nuk do të hiqnim dorë nga ty.”* Dëshira qëndron më lart se pajtimi dhe nënshtrimi, rrënja e dëshirës është besimi në rrugën e udhërrëfyesit dhe qëllimit. Dhe, mungesa e dëshirës është tregues i mosbesimit të rrugës së udhërrëfyesit dhe qëllimit.



*Përsa i përket
çështjes së motivit.*

Islami i kushton mjaft vëmendje motivit të njeriut, madje edhe ngopja e të uriturve në qoftë se nuk bëhet mbi bazën e sinqeritetit dhe me motiv tjetër përveç Zotit, është e pavlerë. Njëra prej sureve të Kur'anit është sureja “Abese” ku në dhjetë ajetet e para të saj ka qortim të rreptë për vrenjtjen përballë verbërisë, ndërkohë që i verbëri nuk e shikon as vrenjtjen dhe as të qeshurën, por Islami origjinën e të vrenjturit e njih si diçka të shëmtuar, jo për shkak të të kuptuarit ose të të moskuptuarit të njerëzve. Islami i shikon në realitet vlerat dhe antivlerat politike, ekonomike dhe fanatizmin. Motivi i imam Husejnit nuk ishte ekspozimi, përpjekja për të dominuar dhe as hakmarrja, por motivi i tij dhe i shokëve të tij besnikë ishte ndreqja e fesë së gjyshit të tij. Motivi i shokëve të tij nuk ishte arritja tek plaçka, malli, posti dhe ekspozimi. Ata bënë tregti me Zotin prandaj

edhe djali i robëruar i imamit, (imami Sexhxhadi) përballë pallatit të Beni Umejjes mbajti fjalimin duke thënë: *"E falënderoj Zotin aq shumë sa është numri i kokrrizave të rërës."*

<< الحمد لله عدد الرمل و الحصى >>. Zejnebul Kubra (e nderuara Zejnebe, motra e imam Husejnit) urdhëron dhe thotë: "Përveç bukurisë, s'kam parë asgjë tjetër." << ما >>

<< رایت الا جمیل >>. Sa kohë që motivi nuk është për All-llahun, por për tjetërkënd, atëherë në çdo punë do të jenë të pranishme ankesat, dobësitë dhe mosmirënjohja.

Me pak fjalë, Islami i kushton vëmendje gadishmërisë së përballjes me armikun në të gjitha aspektet: ⁴⁷ << واعدوا لهم ما استطعتم من >>

<< قوة >>. ***"E ju përgatituni me sa të keni mundësi force..."*** Megjithëse ndodhet pranë të huajve, i kushton rëndësi specializimit në fusha të caktuara të dijes << اطلب العلم و لو بالصين >> ***"Kërkoje diturinë"***

qoftë edhe në Kinë.” Po kështu, i kushton vëmendje edhe mbrojtjes së individëve >>
<< تعاونوا على البر والتقوى. **“Ndhimohuni mes vetes në të mira dhe të mbara.”** Gjithashtu, i kushton vëmendje pasurisë dhe informacionit, por se të gjitha këto janë në vend të syzeve, mjete për të shikuar, mirëpo veprimi i të shikuarit vjen nga syri dhe suksesi është vetëm prej All-llahut. >> وما تو
<< فيقى الا بالله>> **“Suksesi im është vetëm me ndihmën e All-llahut...”** **“...dhe ngadhënjimi e triumfi është vetëm prej tij...”** << وما النصر الا من عند الله >>



Shoqata

Vetëdija

Fladi

Sot aviatorët specialë bombardojnë një krahinë pa e ditur pse dhe për çfarë? Në Kerbela shokët besnikë të Imam Husejnit (a.s) ishin të vetëdijshëm. Prej fillimit të udhëtimit e deri në Kerbela, të gjitha fjalitë e Imam Husejnit (a.s) ishin treguese të vetëdijes se ky udhëtim nuk do të ishte i lidhur me suksesin material dhe se kthim prapa nuk do të kishte, por ishte një zgjedhje e lirë, e vetëdijshme, me devocion dhe nga dashuria. Madje në Islam ka vlerë edhe loti dhe përvëlimi i zemrës kur është mbi bazën e vetëdijes. تقيض اعيينهم من الدمع مما عرفوا ***“Prej syve të tyre rrjedhin lotë, ngase e kanë kuptuar të vërtetën.”***

Kur vjen besimi dhe bindja, njeriu nuk ngurron më në punën e tij. Zejnebul Kubra në fjalosje me Jezidin thotë: ***“Unë të njoh (nënçmoj) ty se sa i poshtër je.”*** انى لا ستصغرک

Vërtet, në qoftë se njeriu arrin bindjen e

vërtetë nëpërmjet ndikimit të njohjes, atëherë piqet dhe asnjë gjë e pjekur nuk kthehet më në të papjekur. Por, në qoftë se nxehet dhe kjo ndodh mbi bazën e ndjenjave dhe motive, ka mundësi që pas një periudhe do të preket nga dyshimi dhe do të ftohet, sepse çdo gjë e nxehtë ftohet përsëri.

Në Kur'an përmenden dy lloje hyrjesh: hyrja e besimit në ambjentin e zemrës dhe hyrja e njerëzve në ambjentin e besimit, gjë e cila është e lehtë. ⁵²يدخلون في دين الله أفواجا

“Dhe i pe njerëzit që hynë turma-turma në fenë e All-llahut.”

Por, hyrja e besimit në zemër është më e vështirë. ⁵³وَلَمَّا يَدْخُلُ الْإِيمَانُ فِي قُلُوبِكُمْ ***“E ende nuk po ju hyn besimi në zemrat tuaja.”***

Tani që jemi duke shkruar këto rreshta, është nata në të cilën Hz. Aliu (a.s.) u zgjodh për udhëheqës në ditën e “Gadir

Humit.” Kishte njerëz që e panë këtë skenë dhe e uruan (për zgjedhjen e tij), por pas pak e braktisën, sepse nuk kishte hyrë ende imani (besimi) i plotë në zemrat e tyre.

Kjo është edhe diferenca midis hyrjes së njerëzve në fe dhe hyrjes së fesë tek njerëzit.



Shoqata

Flladi



Shogata

Lëvizja e

Imam Husejnit mbi

bazën e Kur'anit

Ajetet në të cilat u mbështet Imam Husejni (a.s) përgjatë vijës së rrugës së tij:

♠ **Ajeti i parë:** Sapo që përfaqësuesi i Jezidit në Medine, Mervani, mori vendim që t'i marrë besën Imam Husejnit (a.s) për Jezidin, Imam Husejni (a.s) urdhëroi dhe tha:

و يلك يا مروان فانك رجس

“Mjerë ti, o Mervan! Ti je i ndyrë, kurse në jemi ajo familje, për të cilën All-llahu në favorin tonë ka urdhëruar dhe thënë:

انما يريد الله ليذهب عنكم الرجس اهل البيت و يطهركم
تطهيراً (54)

“Me të vërtetë All-llahu don të largojë nga ju o familje e Profetit, ndyrësitë dhe t’ju pastrojë deri në skaj.”

♠ **Ajeti i dytë:** Imam Husejni (a.s) në fund të testamentit që kishte shkruar para se të lëvizte në drejtim të Kerbelasë, u mbështet në këtë ajet:

...و ما توفيقى الا بالله عليه توكلت واليه انيت ⁵⁵

“...por këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e All-llahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm tek Ai jam i drejtuar.”

Suksesi im nuk është me dëshirën time, por me dëshirën e All-llaut, tek i Cili drejtohem.

♠ **Ajeti i tretë:** Posa refuzoi që t'i jepte besën Jezidit dhe po dilte jashtë Medines në drejtim të Mekkes (28 Rexheb), imam Husejni këndoi këtë ajet:

فخرج منها خائفا يترقب قال ربّ نجّني من القوم الظالمين

56

“E ai (Musai) doli prej aty i frikësuar duke pritur (se ç'po ndodh) dhe tha: O Zoti im! Më shpëto prej popullit zullumqar.”

♠ **Ajeti i katërt:** Shejhul Mufidi (Zoti e mëshiroftë) thotë: Imam Husejni sapo u bë gati për të udhëtuar në drejtim të Medines, grupe të shumta prej xhinnësh dhe melaikesh u bënë gati për ta shoqëruar dhe

për t'i ardhur në ndihmë, por imami këndoi këtë ajet të madhëruar:

57 ايما تكونوا يدرككم الموت و لو كنتم في بروج مشيِّدة

“Kudo që jeni vdekja do t'ju kapë, po edhe në qoftë se jeni në pallate të fortifikuara.”

Po kështu ajeti: لبرز الذين كتب عليهم القتل الى مضاجعهم ***“Thuaj: edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, atyre që u është caktuar mbyrtja (vdekja), do të dilnin në vendin e flijimit të tyre!”***

Personat që u vranë, në fatin (paracaktimin) e tyre ka qenë shkruar se do të lëvizin (me këmbët e veta) drejt vendflijimit të tyre.

♠ **Ajeti i pestë:** Imam Husejni (a.s), sapo hyri në Mekke, në natën e Xhumasë së tretë të muajit Sha'ban (para se të lëvizë për në Kerbela), këndoi këtë ajet:

و لما توجه تلقاء مدين قال عيسى ربّي ان يهدني سواء السبيل⁵⁹

“Dhe kur u drejtua nga Medjeni tha: Shpresoj që Zoti im të më orientojë në

rrugën e drejtë.”

♠ **Ajeti i gjashtë:** Po ashtu, kur po bisedonte me Ibn Abbasin në Mekkë rreth Beni Umejjes, këndoi këtë ajet:

انهم كفروا بالله و برسوله و لا يأتون الصلاة و ه كسالى⁶⁰

“...ata mohuan All-llahun dhe të dërguarin e Tij, dhe namazin e falin vetëm me përtaci...” dhe po ashtu ajeti:

يراثون الناس و لا يذكرون الله الا قليلا

“...falen me përtaci sa për t'u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin All-llahun.” dhe ajeti:

مذبذبين بين ذلك لا الى هؤلاء و لا الى هؤلاء و من يضل الله فلن تجد له سبيلا⁶¹

“Ata janë të luhatshëm ndërmjet atij dhe atij (besimit mosbesimit) e nuk janë as me ata (me besimtarët) as me ata (jobesimtarët). Po atë që e mposht All-llahu, ti nuk mund të gjesh shpëtim për të.”

Dhe tha:

كلّ نفس ذائقة الموت و انما توفون اجودكم⁶²

“Çdo gjë e gjallë do ta shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen Ditën e Kijametit.”

♠ **Ajeti i shtatë:** Në prag të ditës së Kurban Bajramit, kur Imam Husejni (a.s) lëvizi prej Mekkes në drejtim të Kerbelasë, përfaqësuesi i Jezidit në Mekke ia bllokoi rrugën Imamit. Konflikti që lindi midis dy grupeve u konfrontua deri në goditjet me kamxhikë. Ndërkohë, ai i tha Imam Husejnit: “Trembem se mos ju do të mbillni përçarje në popull!!!” Hz. Imam Husejni këndoi këtë ajet:

لی عملی و لكم عملکم انتم بريئون مما اعمل و انا بریء
مما تعملون⁶³

“Mua më takon (shpërblimi nga) vepra ime e juve veprimi juaj, ju nuk përgjigjeni për atë që bëj unë, e as unë për atë që bëni ju.”

♠ **Ajeti i tetë:** Sapo dëgjoji për shehadetin (rënien dëshmor) të Muslim

Akijlit, drejt udhës së tij për në Kerbela, urdhëroi dhe tha:

أَنَا اللهُ وَاَنَا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ

Personat të cilët i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Ne jemi të All-llahut dhe vetëm tek Ai kthehemi.”

♠ **Ajeti i nëntë:** Pranë Kerbelasë, kur Hurri i tha Imam Husejnit: Pse ke ardhur? Imam Husejni urdhëroi dhe tha: *“Letrat që ju m'i dërgonit dhe më ftonit më sollën mua këtu, por tani e shoh se jeni penduar.”* dhe këndoi këtë ajet:

فَمَنْ نَكَثَ فَإِنَّمَا يَنْكُثُ عَلَى نَفْسِهِ⁶⁵

“E kush e thyen (zotimin), ai e thyen vetëm në dëm të vetes së tij.”

♠ **Ajeti i dhjetë:** Përgjatë udhëtimit për në Kerbela, sapo dëgjoji për rënien dëshmor të korrierit të tij (Kajs ibn Musahhar Es Sajdauij), qau e pastaj këndoi këtë ajet:

فَمَنْهُمْ مَنْ قَضَىٰ نَحْبَهُ وَمَنْهُمْ مَنْ يَنْتَظِرُ وَمَا بَدَّلُوا⁶⁶ تَبَدُّلًا.

“...e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën, dhe ka prej atyre që janë duke pritur (ta zbatojnë) dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi.”

♠ **Ajeti i njëmbëdhjetë:** Sapo kryekomandanti i Kufes (Ibn Zijadi) dërgoi një letër zyrtare për Hurrin që ky t'ia bllokonte rrugën Imam Husejnit, ai ia përgatiti letrën Imamit, në këtë kohë Imam Husejni këndoi këtë ajet:

وجعلناهم ائمة يدعون الى النار....⁶⁷

“Dhe ata i bënë prijësa që thërrasin për në zjarr....”

♠ **Ajeti i dymbëdhjetë:** Në Kerbela, Imam Husejni i rrethuar nga ushtria e Jezidit i këndoi këtë ajet vajzës së tij Sukejnës:

استحوذ عليهم الشيطان فانساهم ذكر الله⁶⁸

“Ata i ka nënshtuar djalli, dhe ua ka harruar porositë e All-llahut.”

♠ **Ajeti i trembëdhjetë:** Në ditën e

Ashurasë (ditën e dhjetë) këndoi këtë ajet për ushtrinë e Jezidit:

فاجمعوا امرکم و شركائکم ثم لا یکن امرکم غمّة ثم
69 اقضوا الی و لا تنظرون.

“... ju vendosni për qëllimin tuaj, thirrni në ndihmë edhe zotat tuaj, e mos e mbani fshehtë, dhe zbatoni atë kundër meje e mos pritni.” Po ashtu edhe ajetin:

70 انما ولیّی الله الذی نزل الکتاب و هو یتولّى الصالحیم.

“Mbrotjësi im është All-llahu që zbriti librin qiellor. Ai kujdeset për të mirat.” Po ashtu edhe ajetin: و ائىٰ عذت برّبىٰ و ربکم ان
71 "Unë i jam mbështetur Zotit tim dhe Zotit tuaj nga (kërcënimi) që më gurëzoni (më mbytni)." Gjithashtu edhe ajetin:

اعوذ برّبىٰ و ربکم من کلّ متکبر لا یؤمن بیوم الحساب.

72 "Unë i mbështetem Zotit tim dhe Zotit tuaj që të më mbrojë prej çdo kryeneçi, që nuk i beson ditës së përgjegjesisë."



*Symet e Kur'anit
dhe të
Imam Husejnit (a.s)*

Në Islam, sa herë që bëhet kritikë ndaj *fesadit* (shkatërrimit të rendit shoqëror), po aq herë urdhërohet lidhur me *islahun* (përmirësimin). Kur'ani nuk mjaftohet vetëm me *imanin* (besimin) dhe devotshmërinë e brendshme, por e numëron përmirësimin si domosdoshmëri të besimit dhe të devotshmërisë.

وَأْمِنْ وَأَصْلِحْ⁷³ “*E kush besoi dhe u përmirësua.*” فَمَنْ اتَّقَىٰ وَأَصْلَحْ⁷⁴ “*Ai që ka besuar dhe bën përmirësim.*”

Vetë Zoti është i pari përmirësues وَأَصْلِحْ⁷⁵ “*dhe ua përmirëson gjendjet*” dhe kërkon prej njerëzve që në fillim të përmirësojnë të metat e tyre تَابُوا وَأَصْلَحُوا...⁷⁶ “*Përveç atyre që u penduan dhe u përmirësuan...*” dhe më tej të angazhohen në përmirësimin e shoqërisë. فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَصْلِحُوا ذَاتَ بَيْنِكُمْ⁷⁷

“*...Prandaj kinie frikë All-llahun, dhe përmirësoni gjendjen tuaj...*” Përmirësuesi

nuk ndjek kurrë gjurmët e atyre që provokojnë të këqija.

78 *“Dhe për mirëso, e mos ndiq rrugën e shkatërruesve.”* Natyrisht që përmirësimet duhet të jenë mbi bazat e drejtësisë dhe ligjit. 79 *فصلحوا بينهما بالعدل و القسط*

“...atëherë, bëni pajtim me drejtësi ndërmjet tyre...”

Ai person i cili ia bllokoi vetes së tij rrugët e përmirësimit dhe të pajtimit do të shkatërrohet, goftë edhe bir profeti: *انه ليس من اهلك انه عمل غير صالح.* 80

“O Nuh! Ai (djali) nuk është nga familja jote (për të cilën të premtova se do t'i shpëtoj) ai ishte punëkeq...”

Evlijatë e All-llahut e lusin Zotin që t'i bashkojë me të mirët.

81 *“Zoti im, më dhuro mua urtësi dhe më bashko me të mirët.”*

Zakonisht Kur'ani e ka shoqëruar besimin

shoqëror me veprat e mira:

الذين آمنوا وعملوا الصالحات **"Ata të cilët besuan dhe bënë punë të mira..."**

Ndikimi i punëve të mira nuk është i përkufizuar me kohën dhe vendin, madje edhe prej punëve të baballarëve të mirë që kanë pasur. ⁸² "....edhe **babai i tyre ka qenë njeri i mirë...**"

Kur'ani e sheh qëllimin e përfitimit të të mirave në bazë të zbatimit të veprave të mira.

⁸³ "O **ju të dërguar, hani atë që është lejuar dhe e mirë dhe bëni vepra të mira...**"

domethënë përfitimi dhe shfrytëzimi juaj prej mirësive duhet të jetë për zbatimin e punëve dhe veprave të mira. Zoti i Madhëruar do t'ia lërë qeverisjen e ardhshme të tokës robëve të mirë të Tij.

⁸⁴ "...se me të **vërtetë tokën do ta trashëgojnë robët e Mi të**

mirë.

Njeriu pas përmirësimit të vet duhet të merret me përmirësimin e të tjerëve dhe ta përdorë të gjithë mundin e tij në këtë drejtim. ⁸⁵ **إِنْ أُرِيدُ إِلَّا الْإِصْلَاحَ مَا اسْتَطَعْتُ**

"Unë nuk dua tjetër vetëm t'ju përmirësoj aq sa mundem."

Natyrisht që All-llahu i Madhëruar, kërkuesi i vërtetë i përmirësimit, do t'i veçojë prej atyre që hedhin parrullat e përmirësimit dhe do t'i nxjerrë në shesh fytyrat e pretesuesve të rrejshëm.

قالوا انما نحن مصلحون ألا انهم هم المفسدون و لكن لا يشعرون.⁸⁶

"Ata thanë: Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)! Vini re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë."

Por, All-llahu i njeh punëmirët e vërtetë.

⁸⁷ **و الله يعلم المفسد من المصلح** ***"...All-llahu di të dallojë qëllimkeqin nga qëllimmi."***

All-llahu ka premtuar shpërblim për përimi-

rësuesit e vërtetë.

انا لا نضيع اجر المصلحين.⁸⁸ “...*Ne nuk e humbasim shpërblimin e të mirëve.*”

Ajo ç'ka është për t'u vënë re është se sado që peshorja e të këqijave të shkojë lart, aq më tepër lipset përpjekja për përmirësim. (Thuhet se sado që koha të bëhet e nxehtë, aq më tepër rritet nevoja për ujë dhe...) Sado të rrezikshëm të bëhen të këqinjët, aq më tepër nevojiten (kërkohen) përmirësuesit.

Dihet se me Nemrudin u përball Ibrahim (a.s), me Faraonin u përball Musai (a.s), ndërsa me Jezidin, kush tjetër përveç Husejnit (a.s) do të mund të përballej?!

Është mëse e qartë se programi i përmirësuesve nuk përparon gjithmonë vetëm me letra, biseda dhe përmendje, por ka raste që patjetër duhet përçafuar rreziku. Imam Husejni (a.s) është i pari përmirësues i Islamit që shkoi drejt përçafimit të vështi-

rësive më të ashpra dhe shpirtin e tij ia nënshtroi të vërtetës duke mbërritur në martirizim (duke rënë shehid, dëshmor).





*Urdhërimi në punë
të mira dhe Imam
Husejní (a.s)*

Urdhërimi për punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat është tregues i ndërgjegjes që rri zgjuar, i djegies shpirtërore dhe zotimit (marrjes mbi supe të përgjegjësisë), i dashurisë për shkollën e Islamit, i pranisë në skenë dhe i dashurisë për popullin.

Urdhërimi për punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat është shkak i vetëbesimit të punëmirët, kontrollit të kundërshtuesve dhe ruajtjes së të drejtave të atyre që u janë rëmbyer ato.

Një shoqëri indiferente dhe e heshtur është një shoqëri e vdekur dhe e paudhëzuar. Hz. Luti (a.s) urdhëroi popullin që heshte përballë mëkatit duke i thënë: **أليس منكم رجل** ⁸⁹ **رشيد. "...vallë a nuk paska prej jush asnjë njeri të marrë vesh?"**

Kur'ani njeh si kusht që një popull të jetë "*më i miri*", kryerjen e urdhërimit për të mira dhe ndalimit nga të këqijat.

"Ju jeni populli ⁹⁰ **كنتم خير امة أخرجت للناس...**

më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve...”

Dhe atëherë kur të zbresë zemërimi i Allahut mbi ata që kundërshtuan, All-llahu do t'u japë shpëtim atyre që ndalonin prej të keqes.

”Ne i shpëtuam ata që ndalonin nga të këqijat.”⁹¹ وانجيننا الذين ينهون عن السوء.

Një prej mirësive të namazit është se ai e largon njeriun prej të ndaluarave.

”...vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat...”⁹² ان الصلوة تنهى عن الفحشاء والمنكر.

Udhëzimi në të mira ka si partner shpërblimin e kryerjes së të mirave. Braktisja e urdhërimit për të mira bëhet shkak i sundimit të pandershëm.

Udhëzimi në të mira dhe ndalimi prej të këqijave është detyra e të gjithë të dërguarve gjatë rrjedhës së historisë.

لقد بعثنا في كل امة رسولا ان اعبدوا الله و اجتنبوا

الطاغوت. 94

"Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: Adhuroni vetëm All-llahun e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!"

Imam Husejni (a.s) mbi arsyen e revolucionit të tij urdhëron dhe thotë: "Vallë nuk po e shikoni se nuk veprohet në bazë të së vërtetës (hakkut) dhe nuk i paraprihet së kotës (batilit)?"⁹⁵

"Parimi im (sado që të jetë në rënien dëshmor dhe derdhjen e gjakut tim) është: Urdhërim në të mira dhe ndalim nga të këqijat." ائى ارید أن أمر بالمعروف...

Por çështja e urdhërimit në të mira dhe e ndalimit nga të këqijat ka fazat e saj, edhe pse në disa raste duhet mbërritur deri në rënien dëshmor, duke u derdhur edhe gjaqet e shenjta në rrugën e saj.

و يقتلون الذين يأمرون بالقسط. 96 **"...vrasin edhe njerëz që këshillojnë për të drejtën."**



Një pjesë njerëzish, për të ndenjur të qetë,
nxjerrin justifikime të ndryshme si p.sh.:

Kësaj pune i ka kaluar koha.

Nuk vjen pranvera me një lule.

*Mua dhe atë nuk do të më vendosin në një
varr.*

Isai në fe të vet dhe Musai në fe të vet.

Të tjerë janë, çfarë i lidh me ne.

*Është e ndaluar hyrja e të tjerëve në jetën e
një personi.*

*Mua më është prerë buka, ndërsa njerëzit
indinjohen prej meje.*

*Druhem që t'ia them këtë për shkak të
afritetit që kam, e të tjera justifikime.*

Por, revolucioni i Imam Husejnit (a.s) u bë
shkak që me një lëvizje të sigurtë të mund
të evoluojë historia, si dhe që me një lule të
vijë pranvera.

Prandaj duhet që të përballemi me djajtë. Le
të shkojmë poshtë thundrës së kalit, por
kurrë nën barrën e shtypjes. Le të na i

shkojnë kokat nëpër ushta, por kurrë të mos i përkulim ato para padrejtësisë dhe nuk duhet të imagjinojmë që pasojat e urdhërimit në të mira dhe ndalimit nga të këqijat do të jenë urgjente, sepse ndonjëherë ndikimi i një fjale, lëvizjeje apo revolucioni, del në pah pas vitesh të tëra.





Shoqata
Dukuritë e Kur'anit
në Kərbela

Fillovi

Kur'ani shumë herë urdhëron dhe thotë: Bazohuni mbi logjikën dhe të vërtetën dhe jo mbi numrin e personave:

اکثرهم 98 اکثرهم فاسقون. 97 اکثرهم لا يعلمون.
99 کاذبون.

Shumë prej tyre nuk dijnë,⁹⁷ shumë prej tyre janë të shturur,⁹⁸ shumë prej tyre janë gënjeshtarë.⁹⁹

Kur'ani urdhëron dhe thotë: Çdo hap dhe fjalë duhet të jetë mbi baza të qarta dhe me vetëdije.

100 ادعوا الى الله على بصيرة انا و من اتبعنى .

"Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje."

Imam Husejni, Hz. Ebul Fadl Abbasi dhe besnikët e tij në Ditën e Ashurasë (ditën e dhjetë të muajit Muharrem), mbajtën 10 fjalime të shkurtra për të këshilluar dhe udhëzuar popullin.

Kur'ani i respekton sakrifikuesit: و يوثرون

101 على انفسهم.

"...ata nuk ndjejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë..."

Në Kerbela të zinte syri mjaft dukuri në lidhje me sakrificën dhe një shembull i qartë i kësaj sakrifice ishte hz. Ebul Fadl Abbasi (a.s).

Kur'ani na rekomandon kërkimin e faljes dhe pranimin e ndjesës së njerëzve dhe shembull i qartë i kësaj ndjenje dhe faljeje është Hurr ibni Jezid Err Rrijahi.

102 والعاقبة للمتقين و Kur'ani urdhëron dhe thotë:

"...ardhmëria e lumtur është për të devotshmit."

103 والعاقبة للتقوى "..." e ardhmja (e mire) i takon devotshmërisë."

Në Kerbela, emri i mirë nuk u përket dhjetra mijëra kriminelëve, por ky emër mbeti i gjallë për 72 trupat e shokëve të Imam Husejnit (a.s).

Kur'ani urdhëron dhe thotë: **"O i Dërguar!**

Ne e ngritëm lart kujtimin tënd.”

¹⁰⁴ ورفعالک ذکرک.

Në Kerbela emri i Imam Husejnit qëndroi përherë famëlartë. Kur'ani urdhëron dhe thotë: امرت لان اكون اول المسلمين ¹⁰⁵ ***“Dhe jam urdhëruar të jem i pari i myslimanëve!”***

D.m.th. prijësi duhet të prijë i pari dhe në Kerbela Imam Husejni e dërgoi të birin e tij Ali Ekberin në shesh të betejës përpara të rinjve të tjerë të Beni Hashimit.

Kur'ani urdhëron: فاستقم كما امرت و من تاب ¹⁰⁶ ***“Ti (Muhammed) përqëndrohu vendosmërisht ashtu siç je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u penduan!”*** O i Dërguar!

Ti dhe shokët e tu përqëndrohuni vendosmërisht... E në Kerbela do të shohim shfaqet më të mira të vendosmërisë prej Imam Husejnit dhe besnikëve të tij.

Kur'ani, në vend të përmendjes së emrave të individëve, na sqaron bazat dhe nivelet.

P.sh. urdhëron dhe thotë: Zotëria juaj është

ai person i cili në rukunë e namazit të tij ia dha unazën e vet nevojtarit dhe për një moment bashkoi dy ibadete, namazin dhe zekatin, dhe ky popull duhet të kërkojë dhe të gjejë domethënien e këtij ajeti.

Në Kerbela, Imam Husejni nuk tha: Unë nuk i jap besën Jezidit, por, urdhëroi e tha: *مثلى لا يبايع مثله* "Një i tillë si unë nuk ia jep besën një të tilli si ai." D.m.th. vija e konfliktit midis *hakkut* (të vërtetës) dhe *batilit* (të keqes) ishte, është dhe do të jetë e qartë gjithmonë përgjatë historisë.

Kur'ani urdhëron: ¹⁰⁷ *ويدرون بالحسنة السيئة*
"**...dhe me të mirë largojnë të keqen.**" Në Kerbela, Hurri ia mbylli rrugën Imamit, por Imam Husejni u jepte ujë të eturve të ushtrisë së Hurrit, madje edhe kuajve të tyre. Kur'ani rekomandon ndjekjen e rrugës së Allahut, të *evlijave* (dashurve) të Tij dhe bashkësisë. Një pjesë e ihtarëve të Imam Husejnit që nuk e kursyen shpirtin e tyre

për faljen e namazit të drekës së Ashurasë (ditës së dhjetë), duke i blerë shigjetat e vdekjes me shpirtrat e tyre, në kohën që imami pas faljes së namazit në momentet e fundit të jetës së dytë u vinte pranë dhe u qëndronte mbi kokat e tyre, ata e pyesnin: *Vallë, a e mbajtëm besën?* Thujse deri në atë moment kishin dyshime lidhur me besnikërinë e tyre!

Kur'ani në shumë prej ajeteve urdhëron për *teuhidin* (Njësimin e All-llahut).

Fjalja që thotë Imam Husejni لا معبود سواك “*Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje.*” nxjerr në pah më mirë këtë citim. Kur'ani rekomandon në ndalimin e punëve të këqija, që të kemi ambicje për fenë dhe për mbrojtjen e kufijve dhe normave të etikës dhe moralit. Në Kerbela, fjalia e fundit e Imam Husejnit (i zhytur në thellësinë e kësaj thertorje) për ushtrinë e Jezidit ishte: *Mos i sulmoni çadrat e mia dhe kursehuni*

në prekjën e nderit tim edhe në qofshi të pafe, të paktën në këtë botë kini një farë burrërie! Kur'ani urdhëron për nënshtrimin dhe pajtimin në prani të Zotit. Imam Husejni si atëherë kur ishte mbi supet e Profetit (s.a.v.s), ashtu edhe në ditën kur ishte nën thundrën e kuajve, ishte plotësisht i nënshtruar ndaj Zotit.



Shoqata

Fladi



Shoqata

*Krenaria dhe
poshtërimi në
Karbela*

Filadi

Në programet e Islamit i është kushtuar vëmendje e veçantë çështjes së krenarisë. Adhurimi që i bëhet Zotit të Dashur është krenari e Krijuesit, por robërimi përballë diçkaje tjetër përveç All-llahut (dashuria ndaj asaj që ka shpirt apo diçkaje tjetër) është poshtërim **كفى بي عزاً ان اكون لك عبداً**
"Jam krenar të jem rob i Yti!" Zgjatja e duarve të njerëzve për dhënie bese përmbi duart e udhëheqësve jo të pastër është fyerje ndaj njerëzimit dhe një zvarritje poshtëruese e njerëzimit. Çdo punë që bëhet me qëllim tjetër përveç Zotit (për çdo gjëje dhe këdo qoftë) është humbje.

خاب الوافدون على غيرك و خسر المتعرضون الا لك.

Në qoftë se në Islam përgojimi, fjalët e ndyra, fyerjet, tallja, poshtërimi, zbulimi i sekreteve, tinzaria, thumbimi, bamirësia dhe e përmendura e saj atyre që ua bën këtë të mirë, e thirrura me emër të keq (nofkë poshtëruese), mallkimi dhe sharja janë

haram (të ndaluara), kjo është për arsye se me këto punë thuhet krenaria e të tjerëve.

Në qoftë se lavdërimi i diktatorëve zullumqarë tund edhe *Arshin* e All-llahut, kjo ndodh për arsye se janë lavdëruar të padrejtët.

Në qoftë se njeriu nuk ka të drejtë që t'ia tregojë të metat, mëkatet dhe dobësitë e veta, madje edhe miqve më të afërt të tij, kjo është për shkak të ruajtjes së krenarisë së tij.

Në qoftë se është rekomanduar përcjellja e xhenazesë, ndihmesa e të varfërve, vizita e të sëmurëve, huazimi i ndihmës financiare, vizitat reciproke, fshehja e të metave të të tjerëve, kjo është bërë për arsye të ruajtjes së krenarisë së njerëzve.

Në qoftë se është urdhëruar për durim, bindje, braktisjen e të pyeturit të njerëzve dhe servilizmit, kjo është bërë për shkak të ruajtjes së krenarisë së njeriut.



Vini re disa pika:

1. Krenari është që asgjë e keqe të mos ndikojë e të depërtojë te ty dhe jo posedimi i mundësive. Ndodh që dikush mund të mos këtë asnjë lloj mundësie materiale, por nuk ndikon tek ai asnjë kërcënim apo lakim, ky individ është individ i pëlqyer dhe po ashtu ndodh që dikush t'i ketë të gjitha llojet e mundësive, por përsëri individët dhe gjërat ndikojnë tek ai dhe këta individë janë individë të pashtëruar.

2. Zanafilla e të gjitha krenarive është Zoti. Në Kur'an vazhdimisht këndojmë: انّ العزّة لله جميعا “*S'ka dyshim se e tërë krenaria është e All-llahut.*” Kur'ani e nënçmon kërkimin e krenarisë tjetërkund përpos All-llahut. ايببتغون عندهم العزّة¹⁰⁸ “*Vallë a mos kërkujnë fuqi te to?*”

3. Përujja përballë të vërtetës është krenari. العزّ ان تدلّ للحقّ¹⁰⁹. Shejtani e kërkonte krenarinë në faktin se rraca e tij ishte krijuar prej zjarrit, ndërkohë që

krenaria e tij ishte nën hijen e nënshtrimit ndaj Zotit. Krenaritë e kësaj bote në të vërtetë janë poshtërime. Prijësi i besimtarëve, Aliu (a.s) urdhëron dhe thotë: *“Kjo dynja është e tillë që krenaria e saj është poshtërim.”* Posedimi i një mjeti të bukur që në pamje të parë tregon krenari, po të shihet në brendësi, është me të vërtetë një lloj lidhjeje dhe robërimi i këtij personi karshi këtij mjeti. Bahçeja apo të mbjelljat, në pamje të parë janë krenari për bujkun, por në qoftë se kjo bahçe apo këto të mbjella ia marrin jetën dhe fuqinë bujkut dhe ai nuk mund të hajë prej tyre asgjë, atëherë një gjë e tillë nuk përbën krenari për të. Krenaria ka vlerë kur ajo nuk bëhet shkak mendjemadhësie dhe vetëpëlqimi dhe sado që ajo të shtohet, njeriu në brendësinë e tij duhet ta ndjejë veten sa më të vogël dhe të tregohet sa më modest.

الهي اعزني و لا تبتليني بالكبر و لا تحدث لي عزاً

ظاهرًا إلا احدثت لي ذلّة باطنة عند نفسي بقدرها

110

“O Zot! Më kreno mua, mos më sprovo me mendjemadhësi dhe mos më jep krenari të dukshme pasi më ke dhënë përuljen e brendshme që ke caktuar për mua!”

Kur'ani e konsideron të ndaluar sundimin e jobesimtarëve mbi besimtarët.

“All-¹¹¹lahu kurrsesi nuk ia mundëson jobesimtarëve mbizotërimin e plotë mbi besimtarët.”

Kur'ani e konsideron *haram* (të ndaluar) shtypjen si dhe pranimin e shtypjes.

“...askënd nuk e¹¹² dëmtoni, as vetë nuk dëmtoheni.”

Kur'ani e konsideron *vdekje* të jetuarit me poshtërim, dhe *jetë* vdekjen me lavdi e krenari.

Atë ç'ka Kur'ani e konsideron qëllim është të qënit në rrugë të Zotit dhe nuk e konsi-

deron qëllim në vetvete vrasjen apo të rënit dëshmor.

انّ الله اشترى من المؤمنين انفسهم و اموا لهم بانّ لهم الجنة... فيقتلون و يقتلون ¹¹³

“All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasuritë e tyre me Xhennet. Luftojnë në rrugën e All-llahut, mbysin dhe mbyten.”

Kur'ani e krenoi njeriun duke urdhëruar dhe thënë: ***“E qëna është për ju”***;

Shpirti, si krijim i Zotit është tek ty ¹¹⁴ خلق لكم ¹¹⁵ نفخت فيه من روحى ***“E kur ta përsos atë (në formën e njeriut) dhe t'i jap atij shpirtin që është krijesë e Imja, atëherë ju t'i bini atij në sexhde.”***

Ti je ai para të cilit u përulën engjëjt فسجدوا ¹¹⁶ الا ابليس ***“E kur u thamë engjëjve: përuljuni (bjerini në sexhde) Ademit, ata menjëherë iu përulën, me përjashtim të iblisit (djallit).”***

Ti je mëkëmbës i Zotit; اناى جاعل فى الارض

خليفة¹¹⁷ “(Përkujto o Muhammed) **Kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një mëkëmbës!**”

Kujdestari yt është Zoti; الله وليّ الذين آمنوا¹¹⁸ “**All-llahu është Kujdestari i atyre që besuan...**”

Profetët janë baballarët tuaj ملّة ابيكم ابراهيم¹¹⁹ “**...në fenë e babait tuaj, Ibrahimit.**”

Krijimi yt nuk është pa qëllim وما خلقت الجن و الانس الا ليعبدون¹²⁰ “**Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë.**”

Në Kerbela dalin mjaft mirë në pah aspektet e krenarisë së Zotit.

I riu 13 vjeçar, i larti Kasim (djali i vetëm i Imam Hasanit) thotë: “Në qoftë se Jezidi dhe përkrahësit e tij janë kujdestarë të shoqërisë islame, atëherë vdekja është më e ëmbël se mjalti.”

Imam Husejni thotë: “Benu Umejje më detyruan që të zgjedh ndërmjet rënies

*dëshmor dhe besëlidhjes me ta.” هيهات منا
الله “Poshtërimi është i largët për ne.” Në
Kerbela trupi i Imam Husejnit u bë vrima-
vrima, por këto goditje nuk arritën të ulin
krenarinë e tij dhe as të çënojnë lavdinë e
tij. Mërzitjet dhe dhimbjet i prekën hz.
Zejneben dhe imam Sexhxhadin (a.s), por
aspektet e krenarisë së tyre nëpërmjet
fjalimeve që mbajtën, i çrrënjosën themelet
e regjimit të Beni Umejjes.*

Shahada
Fladi

*Namazi dhe imam
Husejri (a.s)*



Përderisa Kur'ani, në fillim të sures më të gjatë të tij (El Bekare) urdhëron dhe thotë: ¹²¹ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ **“Të cilët e besojnë të fshehtën dhe kryejnë faljen (namazin)...”** dhe po ashtu në suren më të shkurtër të tij (El Keuther) na sjell fjalë rreth domosdoshmërisë së faljes (namazit), Imam Husejni e ka falur namazin ¹²² أَشْهَدُ أَنْكَ قَامْتَ الصَّلَاةَ **“Dëshmoj se ti me të vërtetë e ke falur namazin.”**

Përderisa Kur'ani thotë: **وَارْكَعُوا مَعَ الرَّاكِعِينَ** **“...bini në ruku (përkuluni) me ata që bien në ruku (përkulen).”**, që do të thotë: Faluni me ata që falen.

Imam Husejni e fali atë me xhemat përballë rreshtave të armikut.

Përderisa Kur'ani ia ka mësuar Profetit metodën e faljes së namazit në sheshin e luftës:

...إِذَا كُنْتَ فِيهِمْ فَأَقَمْتَ لَهُمُ الصَّلَاةَ فَلْتَقُمْ طَائِفَةٌ مِنْهُمْ مَعَكَ...
¹²⁴ **“Dhe kur të jesh ti me ata kur të**

vendosësh të kryesh të falurit bashkë me ta, një grup le të kryejnë të falurit me ty, ndërsa të tjerët le t'i kapin armët e tyre dhe derisa të jeni duke u falur, ata le të qëndrojnë pas jush, e pastaj le të vijë grupi tjetër, të cilët nuk e kanë kryer faljen dhe le të falen edhe ata me ty...” Imam Husejni po ashtu është falur në sheshin e luftës.

Përderisa Kur'ani namazin (faljen) e rekomandon si një burim energjie të pashtershme, të fshehtë dhe të ditur dhe i ka urdhëruar besimtarët që të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje tek All-llahu; *استعينوا بالصبر و الصلاة*¹²⁵ **“O ju që keni besuar, kërkonin ndihmë me durim dhe ne të falur (namaz)...”**, Imam Husejni gjithashtu në zjarrin dhe vështirësinë e luftës ka kërkuar ndihmë dhe është mbështetur te namazi (falja).

Përderisa Kur'ani urdhëron faljen e namazit në fillim të kohës; *اقم الصلاة لدلوك الشمس*¹²⁶

“Kryej namazet kur dielli niset nga gjysma e qiellit e deri në terrin e natës...”, Imam Husejni po ashtu e fali namazin e darkës së Ashurasë (ditës së dhjetë) në fillim të kohës.

Përsa i përket Isait (a.s) edhe ai ka qenë i ngarkuar me faljen e namazit derisa të ketë frymë; ¹²⁷ و اوصانى بالصلوة و الزكوة ما دمت حيا

“...dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqatë për sa të jem gjallë.” (Merjem, 31).

Po ashtu, Imam Husejni është bashkërendës me namazin (faljen) deri në momentin e fundit. Përderisa Kur'ani i lavdëron ata njerëz të cilët tregtia nuk arrin t'i shkujdesë prej faljes së namazit, رجال لا تلهيهم تجارة و لا ¹²⁸ بيع عن ذكر الله و اقام الصلوة ***“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregëtia e largët e as shitblerja nga përmendja e Allahut dhe falja e namazit.”***

Lidhur me Imam Husejnin, çfarë duhet thënë që madje as edhe ruajtja e shpirtit nuk

e shkujdesi atë prej faljes së namazit?!

Imam Husejni urdhëron dhe i thotë motrës së tij Zejnebes (a.s): “*Lutu për mua në namazin tënd!*”

Namazi duhet të falet me xhemat (në bashkësi) dhe haptas (اقیموا الصلوة) dhe Imam Husejni megjithëse mund që ta falte namazin brenda në çadër dhe megjithëse namazi i tij nuk ishte i detyrueshëm të falej me xhemat (në bashkësi), ai e fali namazin me xhemat (me bashkësi) përballë atyre njerëzve.

Në kohën e faljes së namazit të drekës së ditës së dhjetë të muajit Muharrem (ditës së Ashurasë) u lëshuan 30 shigjeta në drejtim të Imam Husejnit, d.m.th. përballë çdo fjale të *hamdit* (falenderimit) *rukusë* (përlules) dhe *sexhdes* (rënies me ballë në tokë), për afërsisht i është gjuajtur nga një shigjetë Imam Husejnit.

Me të vërtetë, sa i lartë namazi. Në ikindinë

(pasditen) e ditës së nëntë të muajit Muharrem në kohën që Mbretit të dëshmorëve po i propozohej për sulm, Imam Husejni bisedonte me palën tjetër ushtarake që ta shtynin sulmin edhe një ditë më tej dhe thoshte *انى احب الصلاة* “Unë e dua namazin (faljen)” dhe nuk thoshte: “Unë dua të falem.”?

Zurare e pyeti Imam Sadikun (a.s) rreth Qabes:

Ka disa vite që sa herë ju pyes rreth Haxhit dhe Qabes, ju më jepni nga një përgjigje të re. Dija juaj me çfarë lidhet? Imam Sadiku (a.s) i tha: “Vallë, mos do që Qabes që ka qenë mijëra vjet para Ademit (a.s), t'i mbarojnë të fshehtat vetëm me disa fjalë?!” Kjo ndodhi në kohën që Qabja dhe të gjitha sekretet dhe misteret e saj të cilat Imam Sadiku (a.s) i vuri në dukje, nuk ishin gjë tjetër përveç *kibles* (vëndorientim) së namazit dhe se orientimi nga *kibleja* është

një kusht i namazit (faljes)!!!

Imam Husejni (a.s) po përgatitej që trupi i tij i bekuar të bëhej vrima-vrима, por vlera e namazit kurrë mos të binte poshtë.

Koka e shenjtë e Zotërisë së dëshmorëve vazhdonte të këndonte Kur'an lart mbi ushta, që do të thotë se megjithëse po ndaheshin prej trupit, koka dhe zemra kurrë nuk ndahen prej Kur'anit.

O ju që mbani zi për Husejnin (a.s)! Kohën e drekës së Ashurasë (ditën e dhjetë të muajit Muharrem), kudo qofshi, në kujtim të namazit (faljes) të tij të fundit në Kerbela së bashku me Imam e Zamanit (All-llahu i Madhëruar e shpejtoftë ardhjen e tij të nderuar), falni namazin e drekës së Ashurasë me madhështi dhe sinqeritet.



Shoqata

*Kur'aní dhe kuptimi
í shehidëve
(dëshmorëve)*

Kulturi

Në Kur'an janë lavdëruar personat e guximshëm dhe janë kritikuar ashpër personat frikacakë dhe ata të cilët dëshirojnë një jetë të mirë e të rehatshme

يخشون النَّاسَ كَخَشِيَةِ اللَّهِ ¹²⁹ “...*E kur iu bë atyre obligim lufta, qe një grup prej tyre u frikësoheshin njerëzve siç i frikësohen All-llahut, e edhe më fort...*” dhe لَا طَاقَةَ لَنَا الْيَوْمَ ¹³⁰ “*Ne sot nuk kemi fuqi...*”

P.sh. për të dobësuar moralin e muslimanëve thonin: Armiku juaj është i shumë në numër, por besimtarëve në vend të frikës u shtohet më shumë besimi.

انَّ النَّاسَ قَدْ جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ. ¹³¹ “*E aty (shokëve të Pejgamberit) që dikush u tha: Populli (idhujtarët) është tubuar t'ju sulmojë, pra kini frikë!*” Ajo, vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: *Neve na mjafton që kemi All-llahun, Ai është mbrojtësi më i mirë!*”

Kur'ani i lavdëron ata persona që janë

simpatizantë të Profetit (s.a.v.s) dhe për shkak të pamundësive të shumta derdhin lot.

اعينهم تقيض من الدّم حزناً الا يجدوا ما ينفقون. ¹³²

“...e prej pikëllimit pse nuk kishin me çka të përgatiteshin, nga sytë e tyre rridhnin lotë.”

Kur'ani i lavdëron ata persona që i binden urdhërit për të dhënë jetën dhe gjakun e tyre (ndonëse ky gjak nuk derdhet).

فلما اسلما و تله للجبين ناديناه أن يا ابراهيم قد صدقت الرؤيا. ¹³³

“E kur ata të dy iu dorëzuan urdhërit të Zotit dhe përmbysi atë në fytyrë (në ballë). Ne e thirrëm atë: O Ibrahim! Ti tashmë e zbatove ëndrrën! Ne kështu i shpërblejmë të mirët!”

Kur'ani ata persona që në front tregojnë moral heroik (heroizëm), i konsideron në pozitë të lartë.

...e ¹³⁴ فقتل داود جالوت فاتيناه الملك و الحكمة.

Davudi e mbyti Xhalutin dhe Ne i dhamë atij (Davudit) sundimin, pejgamberllëkun dhe e mësoi atë për çdo gjë që deshi.”

Kur'ani e konsideron si një prej veprave të guximshme të Hz. Ibrahimit (a.s), thyerjen e statujave (idhujve).

135 ***“Pasha All-llahun, posa që të largoheni ju, unë kam për t'ia bërë atë që duhet statujave tuaja!”***

Kur'ani urdhëron dhe thotë:

و كَأَيْنَ مِنْ نَبِيٍّ قَاتَلَ مَعَهُ رَبِّيُونَ كَثِيرٌ فَمَا وَهَنُوا لِمَا
أَصَابَهُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَمَا ضَعُفُوا وَمَا اسْتَكَانُوا وَاللَّهُ
يُحِبُّ الصَّابِرِينَ.¹³⁶

“E sa pejgamberë pati që së bashku me ta luftuan turma të mëdha besimtarësh dhe për atë që i goditi në rrugën e All-llahut, ata nuk u dobësuan dhe as nuk u përulën. All-llahu i di durimtarët.”

Ndoshta një prej të fshehtave të rëndësishme të plotësimit të ceremonisë së Haxhit që është bërë detyrë ndejtja për një natë

jashtë Mekës, në shkretëtirën e Minasë, është fakti se ai vend është vendi i sakrifikimit të Hz. Ismailit (a.s) dhe i përballjes së Hz. Ibrahimit (a.s) me shejtanin.

Po, me të vërtetë domosdoshmëria e ndejtjes tek vendflijimet e evlijave (të mirëve) të All-llahut është një vajtim konkret dhe ruajtje e kujtimit të dëshmorëve.

Në përballjen me këtë grup, Kur'ani i ka kritikuar ashpër grupet e tjera me anë të këtij ajeti:

- 1- Ata të cilët i kanë lidhur zemrat e tyre vetëm me jetën e kësaj bote. **أرضيتم بالحيوة الدنيا “A u kënaqët me jetën (e dynjasë) më të ulët?”**
- 2- Persona të cilët e konsiderojnë mirëqënien e kësaj jete më të dashur se frontin e *xhihadit* (luftës së shenjtë).

قل ان كان ابائكم و ابنائكم و اخوانكم و ازواجكم و
عشيرتكم و اموال اقترفتموها و تجارة تخشون

كسادهما أحبّ اليكم من الله ورسوله و جهاد في سبيله
فترَبَّصوا...

“Thuaj: (o i Dërguar): Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e fituat, tregëtia që frikësohen se do dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se All-llahu, se i dërguari i Tij, atëherë, pritni derisa All-llahu të sjellë çështjen e Tij, e All-llahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur.”

3- Persona që frikësohen prej armikut. . قالو
“Ne sot nuk kemi fuqi kundër Xhalutit dhe ushtrisë së tij.”¹³⁸ الا طاقة لنا اليوم بجالوت و جنوده

4- Ata persona të cilët shtrojnë për diskutim çështjen e pasigurisë së shtëpive të tyre dhe për t'ia mbathur prej luftës kërkojnë leje prej Profetit (s.a.v.s).

يقولون انّ بيوتنا عورة و ما هي بعورة

***“Shtëpitë tona janë të pambrojtura!
Edhe pse ato nuk ishin të pambrojtura,
në realitet ata nuk donin tjetër por
vetëm të iknin.”***

- 5- Personat të cilët për të mos marrë pjesë në front të luftës shfajësoheshin dhe nxirrnin si pretekst se pjesëmarrja jonë në luftën e Tebukut do të bëhet shkak për rënie në mëkat, sepse në përballje me bizantinët do të hidhnin sytë tek vajzat e tyre dhe do të binin pre e *fitnes* (sprovës) dhe mëkatit. Në kohën që *fitneja* (sprova) dhe mëkati më i madh në të cilin ranë ishte dezertimi nga fronti i luftës dhe lënia vetëm e Profetit (s.a.v.s)

و منهم من يقول انذن لي و لا تفتنى الا في الفتنة سقطوا

¹⁴⁰ ***“Dhe prej atyre ka të tillë që thonë:
Më lejo mua (të mos shkoj në luftë) e
mos më vë në provë! Jo, ata mu në***

sprovë kanë rënë (më parë).”

6- Personat të cilët nxorrën si pretekst të nxehtin e ashpër për të braktisur luftën.

¹⁴¹ قالوا الا تتفروا في الحرّ قل نار جهنم اشدّ حرًا .

**“...thanë: Mos dilni (në luftë) në të nxehtë!
Thuaju: Zjarri i Xhehennemit e ka të nxehtin edhe më të fortë, nëse janë që kuptojnë.”**

Ata persona të cilët për shkak se nuk shkuan në front të luftës janë të humbur.

¹⁴² “*Ata (hipokritët) që mbetën (pa shkuar në luftë), u gëzuan për nderjetjen e tyre pas të Dërguarit të All-llahut dhe nuk dëshiruan të luftonin me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e All-llahut dhe thonë: "Mos dilni (në luftë) në të nxehtë!"*

All-llahu i jep urdhër Profetit (s.a.v.s) që të mos falë namaz përmbi ata të vdekur që bënë një jetë të rehatshme dhe kanë qenë të pashpirt, përmbi frikacakët që ia mbathën

nga fronti i luftës, madje as që nuk duhet të jetë i pranishëm mbi kryet e varreve të atyre që ia mbathën prej luftës. Pra, atëherë, nga kjo kuptohet se nuk paska problem të jemi të pranishëm përmbi kryet e mezareve (varreve) të shehidëve. Hz. Fatimeja (a.s) dy herë në javë (të hënën dhe të enjten) ndiqte një rrugë prej disa kilometrash nga shtëpia e saj deri tek varret e dëshmorëve të Uhudit, madje sillte me vete në shtëpi edhe një masë prej dheut të varreve të shehidëve (dëshmorëve) dhe me të ndërtonte kokrra tespihesh dhe me këto tespihe rrethonte dorën në mënyrë që mos t'i harronte shehidët.

Zoti krijoi ç'ka në qiej dhe në tokë اللهُ الذي ¹⁴³ خلق السموات و الارض ***“All-llahu është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën.”*** dhe atë e ka lënë në zotërim (shërbim) të njerëzve:

¹⁴⁴ سَخَّرَ لَكُمْ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ. ***“A nuk e dini ju se All-llahu nënshtroi për të***

mirën tuaj ç'ka në qiej e ç'ka në tokë...”

Dhe i krijoi njerëzit për ta adhuruar dhe përulur para Tij.

و ما خلقت الجنّ و الانس الا ليعبدون.¹⁴⁵ ***“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë.”***

Maja e adhurimit është namazi (falja) dhe maja e namazit është sexhdeja (rënia me ballë në tokë) dhe më e mira rënie në sexhde është të biesh mbi dheun e Kerbelasë dhe turbetin e (copën e dheut të) shehidëve (dëshmorëve), në mënyrë që të mos i harrojmë dëshmorët. Në rregullat e Haxhit lexojmë: Ai person që shkon në Mekkë dhe nuk viziton Profetin në Medine është harbut dhe ai person që shkon në Medine dhe viziton Profetin dhe nuk viziton dëshmorët e Uhudit, në anë të Medinës, ka bërë harbutllëk (ka treguar jo njerëzillëk) prandaj nxjerrim përfundimin se *shenjtëria e Mekkës me profetësinë e*

Medines dhe kjo e fundit me *dëshminë e Uhudit* janë të gërshetuara me njëra-tjetrën, d.m.th. që Meka është e lidhur me Medinen dhe Medineja me Uhudin. Vallë, a mos është rastësi që shehidët (dëshmorët) e Uhudit ishin 72 vetë, shehidët e Kerbelasë 72 dhe po ashtu shehidët e parisë së Republikës ishin 72 veta?!



Shoqata

Fladi



Shoqata

*Zijareti i Ashurasë
në hijen e Kur'anit*

fillo di

Njëra prej bazave që Kur'ani insiston në të është dashuria për të mirët dhe mirësitë dhe mospëlqimi ndaj të këqinjëve dhe të këqijave.

Kur'ani urdhëron dhe thotë: Mëso prej Ibrahimit se si e deklaroi mospëlqimin ndaj Azarit të devijuar që ishte njeriu më i afërt i tij.

فَلَمَّا تَبَيَّنَ لَهُ أَنَّهُ عَدُوٌّ لِّلَّهِ تَبَرَّىٰ مِنْهُ إِنَّ إِبْرَاهِيمَ لَأَوَّاهٌ حَلِيمٌ.
¹⁴⁶ “...e kur iu bë e qartë se ai është armik i All-llahut, u largua prej tij. S'ka dyshim, Ibrahimimi është shumë i ndjeshëm dhe i butë.”

Profeti është i ngarkuar që t'u thotë kështu jobesimtarëve:

أَنْتَىٰ بِرَىٰ مِمَّا تَشْرِكُونَ.¹⁴⁷ “Unë largohem prej asaj ç'ka ju i shoqëroni Zotit.”

Sureja Beraeh (Et Teubeh) është tregues i asaj që nuk mjafton vetëm interesi të jesh i lidhur me veprimet e mira, porse duhet që me sqarim dhe thirrje, me të thënë e me të

shkruajtur, me letër, me vajtim, me lot dhe me vepër të largohemi prej të këqinjve dhe në lidhje me këtë do ta deklarosh mospëlqimin.

Çdo vit, me miliona myslimanë, në territorin e Minasë në anë të shtëpisë së Zotit, duke ndjekur shembullin e Ibrahimit gjatë tri ditëve, po ashtu edhe pas shpine, në drejtim të simbolit të shejtanit, gjuajnë 49 gurë dhe kërkojnë përjashtimin e shejtanit dhe atyre që veprojnë si shejtani nga mëshira e Zotit.

Interesant është fakti se pasi gjuajmë me gurë në drejtim të shejtanit, haxhinjtë këndojnë këtë dua (lutje): *O Zot! Pranoje Haxhin tim!* Ky është misteri i asaj që pranimi i Haxhit është i shoqëruar me izolimin e shejtanit dhe shejtanëve. E pathëna u gjet që shejtani në çdo kohë me ngjasim dhe fytyrë është, ashtu siç ka thënë Imam Homeini (Zoti e mëshiroftë)

“Amerika është shejtani më i madh.” Në zijaretin (vizitën e Ashurasë), të imam Husejnit dhe besnikëve të tij i japim njëqind herë selam dhe armiqtë e tij, të fesë dhe të Zotit, i mallkojmë po njëqind herë.

Përsëritja e gjuajtjes së gurëve në drejtim të shejtanit në territorin e Minasë dhe përsëritja e mallkimit (lanetit) në zijaretin e Ashurasë (vizitën e ditës së dhjetë) është tregues i asaj që duhet ta bëjmë shprehi dashurinë ndaj të mirëve dhe po ashtu ta bëjmë vërshimin e zemërimit ndaj të këqinjve dhe shprehia vjen nga ndikimi i përsëritjes.

Hz. Aliu (a.s) ka lindur në Qabe dhe shtëpia e lindjes së tij është shtëpia e All-llahut. Zoti duket sikur thotë: Silluni rreth Qabes derisa në tavafët rreth shtëpisë së Zotit të zërë vend në shpirtrat tuaj dashuria për Aliun, mendja dhe rruga e tij.

Njeriu pa dashuri dhe pa urrejtje është sikur

kafsha e cila merr vetëm frymë. Çdo ditë e natë dhjetë herë kërkojmë prej Zotit që ne të na udhëzojë në rrugën e evlijave (të mirëve) të patundur të Tij;

اهدنا الصراط المستقيم صراط الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ.

“Udhëzona (përforcona) për në rrugë të drejtë.” Po ashtu, kërkojmë të largohemi prej rrugës së të devijuarve dhe atyre të cilët janë përfshirë në zemërimin e All-llahut.

غير المغضوب عليهم ولا الضالين.

E puthim gurin e Qabes, por në të njëjtën kohë me atë të gjuajtjeve me guralecë në drejtim të shtyllës simbolike të shejtanit, demonstrojmë urrejtjen dhe pakënaqësinë ndaj tij.

Ditën e Arafatit, për dashurinë e Husejnit dhe lutjen ndaj tij derdhim lot, por të nesërmen e saj, ditën e Kurban Bajramit, me thikën në dorë derdhim gjak dhe bëjmë *kurban*. Në njërën dorë duke bërë lutje dhe në dorën tjetër mbajmë armën.

Vërtet, muslimanët duhet të jenë kështu në të gjitha fushat e jetës.

Imamit të Xhumasë (faljes së të premtës) së muslimanëve duhet t'i dëgjohet urdhërimi për devotshmëri, sytë e tij të pikojnë lot, në dorën e tij të qëndrojë arma dhe hapat e tij të jenë të patundur drejt revolucionit, horizontet e dijeve të tij të jenë të hapura dhe mendja e tij tës jetë e mbushur me dije. Ky është kuptimi i shoqërisë së përfaqësuesve të shkollës islame, dijetarëve dhe oratorëve në fenë islame. Përderisa i japim selam (shpëtim, paqë) Imam Husejnit, atëherë jemi mësuar nga Kur'ani që Lajmëtarëve Qiellorë dhe udhëtarëve të Zotit t'u japim selam (shpëtim, paqë).

سلام على نوح فى العالمين¹⁴⁸ ***“Selami i qoftë Nuhut (prej All-llahut e prej krijesave) në mbarë botën (si kujtim i tij).”***

سلام على ابراهيم¹⁴⁹ ***“Selam (shpëtim e paqe) pastë Ibrahim!*”**

150 سلام على موسى و هارون (Përkujtimi)
**“Selam mbi (qofshin të mëshiruar)
Musain dhe Harunin!”**

151 سلام على آل ياسين
**“Selam mbi (qoftë i
mëshiruar) Iljasin (ose edhe besimtarët e
Iljasit).”**

Në qoftë se i dërgojmë selam (paqe dhe
shpëtim) Profetit këtë e kemi mësuar nga
Kur'ani i cili urdhëron dhe thotë:

152 ان الله و ملائكته يصلون على النبي
**“Është e
vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me
madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju
që keni besuar, madhëronie pra atë (duke
rënë salavat) dhe përshëndeteni me
selam.”**

All-llahu i Madhëruar dhe engjëjt e Tij i
çojnë lavde Profetit (s.a.vs), dhe në qoftë se
ne i bëjmë lanet dhe i mallkojmë armiqtë
dhe uzurpatorët e qeverisjes së Hakkut (të
vërtetës) dhe kriminelët e historisë së
njerëzimit, përsëri këtë e kemi mësuar prej

Kur'anit i cili urdhëron:

انّ الذين يؤذون الله ورسول لعنهم الله في الدنيا و الاخرة.

¹⁵³ ***“E s'ka dyshim se ata të cilët e fyejnë All-llahun dhe të Dërguarim e Tij, ata i ka mallkuar All-llahu në dunja dhe Ahiret dhe për ta ka përgatitur një dënim të dhimbshëm.”***

Ne e kemi mësuar mallkimin ndaj armiqve të All-llahut prej Profetëve:

لعن الذين كفروا من بنى اسرائيل على لسام داود و عيسى

¹⁵⁴ ***“Ata që mohuan të vërtetën nga Beni Israilët, u mallkuan prej gjuhës së Davudit dhe të Isait, birit të Merjemes.”***

Ne e kemi mësuar mallkimin nga vetë tradita dhe rruga e Profetit të Islamit, i cili në ndodhinë e ballafaqimit (mubahele) urdhëroi dhe tha:

¹⁵⁵ ***“E kush***

***të kundërshton ty në çështjen e (Isait) pasi të është bërë e ditur e vërteta, ti thuaj:
“...mandej sinqerisht të lutemi për***

mallkim dhe mallkimin nga ana e Allahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve.”

Zoti (xh.sh) i thotë Pejgamberit: Nëse nuk të besojnë për këtë që po të rrëfej Unë, thuaju: Ejani të tubohemi me tërë familjet tona e të tuajat në një vend dhe e lusim Zotin të mallkojë gënjeshtarin.

Pejgamberi u tha dhe doli me familjen e vet; Husejnin në grykë, Hasanin përdore, Fatimen pas tij, e Aliu pas. Mirëpo kundërshtarët nuk patën guxim të dalin, sepse e dinin se ata vetë ishin gënjeshtarë. Me atë rast u dokumentua se Muhammedi vërtet ishte i dërguar i Zotit, por ata nuk donin ta pranonin, e megjithatë i ikën mallkimit por dështuan keq.

(e njëjtë me këtë thënie gjindet edhe tek shënimi i përkthyesit të Kur'ani Kerijmit në gjuhën shqipe, H.Sherif Ahmeti)

Disa kriminelë, jo vetëm Zoti dhe Profeti i mallkojnë, por po ashtu këta kriminelë i

mallkojnë dhe bëjnë lanet pa ndërprerje të gjitha krijesat me shpirt e ndjenja.

156 *“Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato na sqaruan njerëzve në Librin, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë.”*

Është e paktë të themi që selami (shpëtimi dhe paqja) dhe laneti (mallkimi) ynë në të gjitha zjaretet (vizitat) që i bëhen njerëzve të mirë dhe dëshmorëve që ia kushtuan jetën e tyre rrugës së All-llahut (xh.sh) në veçanti në zjaretin e Ashurasë (në vizitën e ditës së dhjetë të muajit Muharrem, ditë në të cilën ka rënë shehid (dëshmor) zotëria i dëshmorëve (sejjidush shuheda) Imam Husejni (a.s) prej dorës së mallkuar të Jezidit, të birit të Muaviut, ka dalë dhe është ngritur prej kulturës dhe shpirtit të Kur'anit.





Shoqata

Filadi


Burimet e librit

- 1- Mexhmaul Bejan, vwll. 2, f. 361
- 2- Kamilu zijarat
- 3- Xhamiul hadith, vwll. 12, f. 481
- 4- Sure "Junus"/49
- 5- Leuaixhul eshban, f. 26
- 6- Sure "El Xhin"/ 1
- 7- Leuaixhul eshban, f. 128
- 8- Sure "El Hixhr /87
- 9- Biharur Anvar, vwll. 98,f. 239
- 10- Sure "El Hakkah" /51
- 11- Kamilu zijarat, f. 202
- 12- Nehxhul Fasahah, fjaliala 662
- 13- Zijaretul ashura
- 14- Kamilu zijarat, f. 70
- 15- Sure "El Isra" /82
- 16- Men la jehderul fakih, vwll. 2, f. 446
- 17- El Hajat, vwll. 2, f. 140
- 18- Mefatihul xhinan
- 19- Nehxhul Belaga, fjalimi 180
- 20- Maktel Khavarizmij, vwll. 1, f. 188
- 21- Sure "En Nisa" /174

- 
- 22- Kamilu zijarat, f. 200
23- Sefinetul bihar, vwll. 2, f. 413
24- Maktl Mukarram
25 Sure "Sad" / 29
26- Maktal Khavarizmij
27- Sure "Ez Zumer" /28
28- Furuul kafij, vwll. 4, f.561
29- Sure "El Uakia" /77
30- Nefsul Mehmum, 7
31- Sure "El Fusilet"/41
32- Luhufun, 54
33- Biharul Anuar, vwll. 92, f. 31
34- Perteva ez adhametul Husejn, 6
35- Sure "El En'am" /157
36- Furuul kafij, vwll. 4, f. 565
37- Sure "El Muzemmil"/4
38- Kamilu zijarat
39- El Uesail, vwll. 4,f. 857
40- Kamilu zijarat
41- Sure "En Nisa /142
42- Sure "Et Teube /54



- 
- 43- Sure "El Bekare /71
44- Sure "Et Teube /38
45- Sure "El Ankebut /65
46- Sure "Junus"/ 91
47- Sure :El Enfal"/60
48- Sure "El Maide"/2
49- Sure "Hud"/ 88
50- Sure "Ali Imran"/ 126
51- Sure "El Maide"/83
52- Sure "En Nasr"/2
53- Sure "El Huxhurat"/14
54- Sure "El Ahzab"/33
55- Sure "Hud"/ 88
56- Sure "El Kasas"/21
57- Sure "En Nisa /78
58- Sure "Ali Imran"/ 154
59- Sure "El Kasas"/22
60- Sure "Et Teube /38
61- Sure "En Nisa /142-143
62- Sure "Ali Imran"/ 185
63- Sure "Junus"/ 41
- 

- 64- Sure "El Bekare /156
65- Sure "El Fet'h"/10
66- Sure "El Ahzab"/23
67- Sure "El Kasas"/41
68- Sure "El Muxhadele"/19
69- Sure "Junus"/ 71
70- Sure "El A'raf"/ 196
71- Sure "Ed Duhan"/20
72- Sure "El Gafir"/27
73- Sure "El En'am"/48
74- Sure "El A'raf"/45
75- Sure "Muhammed"/2
76- Sure "En Nisa /146
77- Sure "El Enfal"/1
78- Sure "El A'raf"/ 142
79- Sure "El Huxhurat"/9
80- Sure "Hud"/ 46
81- Sure "Esh Shuara"/83
82- Sure "El Kehf"/82
83- Sure "El Mu'minun"/50
84- Sure "El Enbija"/105




- 
- 85- Sure "Hud"/ 88
86- Sure "El Bekare /11-12
87- Sure "El Bekare /220
88- Sure "El A'raf"/ 170
89- Sure "Hud"/ 78
90- Sure "Ali Imran"/ 111
91- Sure "El A'raf"/ 164
92- Sure "El Ankebut /45
93- Biharul Anuar, vwll. 97, f.87
94- Sure "En Nahl"/36
95- Biharul Anuar, vwll. 44, f.192
96- Sure "Ali Imran"/ 21
97- Sure "El Enfal"/34
98- Sure "Et Teube /8
99- Sure "Esh Shuara"/223
100- Sure "Jusuf108
101- Sure "El Hashr"/9
102- Sure "El A'raf"/ 128
103- Sure "Ta Ha"/132
104- Sure "El Inshirah"/4
105- Sure "Ez Zumer"/12

- 
- 106- Sure "Hud"/ 112
107- Sure "Err Rra'd/22
108- Sure "En Nisa /139
109- Biharul Anuar, vwll. 78, f.228
110- Duaja "Mekarimul Ahlak"
111- Sure "En Nisa /139
112- Sure "El Bekare /279
113- Sure "Et Teube /111
114- Sure "El Bekare /29
115- Sure "El Hixhr"/29
116- Sure "El Bekare /34
117- Sure "El Bekare /30
118- Sure "El Bekare /257
119- Sure "El Haxh"/78
120- Sure "Edh Dharijat"/57
121- Sure "El Bekare /3
122- Zjaretul Ashura
123- Sure "El Bekare /43
124- Sure "En Nisa /102
125- Sure "El Bekare /153
126- Sure "El Isra"/78
- 

- 
- 127- Sure "Merjem"/31
128- Sure "En Nur"/37
129- Sure "En Nisa /77
130- Sure "El Bekare /249
131- Sure "Ali Imran"/ 173
132- Sure "Et Teube /93
133- Sure "Es Safat/ 101-103
134- Sure "El Bekare /251
135- Sure "El Enbija"/57
136- Sure "Ali Imran"/ 147
137- Sure "Et Teube /24
138- Sure "El Bekare /249
139- Sure "El Ahzab"/13
140- Sure "Et Teube /49
141- Sure "Et Teube /81
142- Sure "Et Teube /80
143- Sure "Ibrahim"/31
144- Sure "Lukman"/20
145- Sure "Edh Dharijat"/56
146- Sure "Et Teube /114
147- Sure "Esh Shuara"/216
- 

- 148- Sure "Es Safat/ 79
149- Sure "Es Safat/ 109
150- Sure "Es Safat/ 120
151- Sure "Es Safat/ 130
152- Sure "El Ahzab"/56
153- Sure "El Ahzab"/57
154- Sure "El Maide"/78
155- Sure "Ali Imran"/ 61
156- Sure "El Bekare /159



Shawata

Fladi



Shoqata

Flladi



Përmbytja

Hyrje.....	3
Kur'ani dhe Imam Husejni (a.s.)	7
Motivi, sinqeriteti, kënaqësia dhe vetëdija në Kerbela	13
Përsa i përket çështjes së motivit:	17
Vetëdija	21
Lëvizja e Imam Husejnit mbi bazën e Kur'anit	25
Synimet e Kur'anit dhe te Imam Husejnit (a.s)	34
Urdhërimi në punë të mira dhe Imam Husejni (a.s)	41
Justifikime pa vend	45
Dukuritë e Kur'anit në Kerbela	48
Krenaria dhe poshtërimi në Kerbela	55
Vini re disa pika:	58
Namazi dhe imam Husejni (a.s)	65
Kur'ani dhe kuptimi i shehidëve (dëshmorëve)	75
Zijareti i Ashurasë në hijen e Kur'anit	83
Burimet e Librit.....	93